

887
05.06.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË SË UST

Tiranë, më 03.06.2019

Drejtuar: **Rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës**

Prof. Dr. Agron CUKA

Lënda : **Raporti i Punës për Muajin Maj i NJSBC-së pranë UST.**

RAPORT

Gjatë muajit Maj 2019 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së UST (NJSBC), e përbërë nga: Prof. Dhimitraq Stratobërdha Kryetar, Dr. Mirjeta Cenaj Anëtar, Doc. Anduela Lile Anëtar ka vazhduar punën në përputhje me detyrat, që u ngarkon Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore të lidhura me punën e NJSBC –ve pranë IAL (UST), bazuar në Plan Veprimin për vitin 2019.

Gjatë muajit maj janë zhvilluar në Universitetin e Sporteve të Tiranës një “fokus grup” me studentët e ciklit të studimit bachelor dhe master, të cilët kanë ndarë eksperiencën e tyre përgjatë viteve të studimit në UST, si dhe kanë dhënë sugjerime në lidhje me mënyrat se si institucioni mund ta përmirësojë më tej ofertën e tij akademike dhe si të ofrojë më shumë mundësi për studentët.

Diskutimet u përqëndruan tek:

Kurrikula, rezultatet e të nxënësve, vlerësimi dhe arritjet.
Infrastruktura e mësimdhënies dhe orët mësimore në Auditor
Vlerësimi i arritjeve, mësimdhënien dhe nxënien
Realizimi i oreve mesimore (ushtrimet)
Përafrimi me tregun e punës. Etj.

Nga ana tjetër u përgatitën, iu shpërndanë studentëve dhe janë duke u mbledhur pyetsoret nga gjithë programet e UST deri në fillimin e sezonit provimeve.

Një raport me rezultatet e focus grupeve dhe pyetësoreve po përgatitet dhe do tju dërgohet gjatë muajit në vazhdim

Ky raport është përgatitur sipas pikës 5 të Vendimit nr. 9 më datë 02.03.2018 të Bordit të Administrimit të UST, në mënyrë që të kryhet pagesa mujore për të tre anëtarët e NJSBC.

Kryetari i NJSBC

Prof. Dr. Dhimitraq Stratobërdha